Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Nr./Br. 126/17
Date/Datum 05.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH. nr. 126/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje Tefik Sylejmani –Kryetar, Ekrem Salihu-Referues dhe Nuhi Paçarizi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 126/17, të parashtruar nga operatori ekonomik N.T.P. "SNR" me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqësoj Lirak Ahmeti, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kushineta dhe hilzne" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës, në seancën e dt. 31 maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet,** ankesa e operatorit ekonomik N.T.P. "SNR" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kushineta dhe hilzne" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121,të shpallur nga autoriteti kontraktues–Korporata Energjetike e Kosovës, si e pa bazuar.

II. **Vërtetohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës, njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizimi me kushineta dhe hilzne" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121, si i bazuar.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues N.T.P. "SNR" me seli Prishtinë janë të paqëndrueshme, i bëhet konfiskimi i sigurimit të ankesës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues– Korporata Energjetike e Kosovës, më dt. 23 mars 2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kushineta dhe hilzne" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 2 (dy) operator ekonomik, ku sipas komisionit të vlerësimit të ofertave asnjëri operator ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Autoriteti kontraktues më dt. 11 prill 2017, njofton operatorin ekonomik ankues me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, me arsyet e eliminimit nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me kushineta dhe hilzne" me nr. të prokurimit KEKO 16/356/121

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 21 prill 2017, operatori ekonomik N.T.P. "SNR" me seli në Prishtinë, në afatin e paparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës, me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit ka bërë shkelje te nenit 4 pika 1.61, 1.62, 1.63 dhe 1.64, nenit 7 paragrafi 1, 2 dhe 4 dhe nenit 59 paragrafi 2 të LPP-së.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e pa bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 02 maj 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me datën 12 maj 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport të ekspertizës i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ta refuzoj si të pa bazuar dhe të mbetet ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Bazuar në atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej ne Rivlerësim.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik i dt. 12 maj 2017, si dhe parashtresën e operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues KEK, përmes parashtresës me shkrim të dt. 19 maj 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 12 maj 2017.

Operatori ekonomik ankues N.T.P."SNR" sh.p.k. Prishtinë, edhe pse ju ka dërguar raporti i ekspertizës, nuk është deklaruar se a pajtohen apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues/ teknike.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues N.T.P."SNR", avokati z. Spahiu, deklaroj: qëndrojmë pranë ankesës së paraqitur pranë OSHP-së dhe pikave të cekura në ankesë.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues në vazhdim të prezantimit theksoi: eksperti shqyrtues/teknik në secilin artikull ka saktësuar se artikujt i përmbushin standardet e kërkuara dhe kërkesa e tij për anulim të tenderit është e paqëndrueshme. Pra, në secilin artikull deklaron se i përmbush standardet e kërkuara.

Në ekspertizë eksperti teknike thotë "i përshtatet kushinetës së ofruar pa shenjën shtesë "J". Tek artikulli nr. 17, vlerësimi i ekspertit teknik është "kushineta NU416 është ne përputhje me specifikat teknike të kërkuara. Po ashtu për artikullin nr. 18, thuhet "kushineta e ofruar 3319 është ne përputhje ne specifikat teknike të kërkuara". Të njëjtën shënon për artikullin nr. 21. Andaj, kërkesa e ekspertit teknik për anulim është e paqëndrueshme dhe ne kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues kërkoja që ankesa ta aprovohet dhe të procedohet pasi është hera e dytë që kalon në fazë të njëjtë, dhe OSHP-ja duhet ti jep zgjidhje këtij tenderi në bazë të dispozitave ligjore.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i autoritetit kontraktues KEK, z. Ahmeti deklaroj: AK-KEK aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me kushineta dhe hilzne"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/356/121, e ka vlerësuar në mënyrë profesionale dhe qëndron pranë vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pikat ankimore për artikullin nr. 5, kushineta e kërkuar 31324XJ2, operatori ekonomik ankues ka ofruar 31324X, pikërisht me "J" tregon se kushineta është me seperatorë, kurse numri dy tregon specifikimin e seperatorit dhe materialin e kushinetës Çelik. Kjo tregon se është kushinetë me kafaz të presuar nga llamarina e çelikut, prandaj për këtë pozicion oferta e operatorit ekonomik ankues nuk është ne përputhje me specifikat teknike të dosjes së tenderit.

Për artikullin nr. 17, është kërkuar kushinetë NU416, sipas standardeve DIN5412, ne ofertën e operatorit ekonomik ankues nuk ka dëshmi që kushineta e ofruar është punuar sipas standardit DIN 5412 apo ndonjë standardi tjerë që është kompatibile me këtë standard.

Për artikullin nr. 18 është kërkuar kushinetë 3319, sipas standardit DIN 628, operatori ekonomik ankues nuk ka dëshmuar se kushineta e ofruar nga ai plotëson këtë standard apo ndonjë standard tjetër kompatibile.

Eksperti shqyrtues/teknik z. Sarkočevič, ne seancën dëgjimore deklaroj: autoriteti kontraktues ka kërkuar kushinetë me kafaz të çeliktë për shkak kushteve që do të punojë. Për ketë edhe qëndron shenja "2" që kafazi duhet të jetë i çeliktë, ndërsa në ofertën e operatorit ekonomik ankues nuk shënon shenja "2".

Eksperti teknik në vazhdim të prezantimit sqaroj, dy pika tjera kushineta NU416 dhe 3319, operatori ekonomik nuk ka ofruar dëshmi se këto janë të punuara sipas standardit DIN dhe kjo po ashtu ka qenë kërkesë e autoritetit kontraktues. Sikurse për disa produkte që janë standarde ISO, në këtë rast autoriteti kontraktues ka kërkuar kushineta të ndërtuara sipas standardit DIN. Standardi DIN dëshmon dizajnin dhe materialin e ndërtimit. Në këto dy pika operatori ekonomik ankues është i pa përgjegjshëm, andaj i rekomandoj panelit që të refuzoj ankesën dhe të vërtetoj vendimin për anulim.

Pretendimi i operatorit ekonomik ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se nuk qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar specifikimet teknike të detyrueshme ashtu siç janë kërkuar ne dosjen e tenderit, respektivisht autoriteti kontraktues ka kërkuar kushinetë J2 kafaz i çeliktë, kurse operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar me shenjen 2 që kafazi duhet të jetë i çeliktë. Po ashtu per kushineta NU416 dhe 3319 operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi se këto janë të punuara sipas standardit DIN, dhe kjo po ashtu ka qenë kërkesë e autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues bazuar ne nenin 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, sqaron se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit si dhe specifikimin teknike, ndërsa operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar specifikimin teknike ashtu siç është kërkuara në Aneksin 1. Specifikimet teknike, të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes se tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues/teknik, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, deklaratës së përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues, deklaratës së përfaqësueses së autoritetit kontraktues, sqarimeve të dhëna nga eksperti teknik gjatës seancës dëgjimore, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e anulimin të aktivitetit të prokurimit me titull: **"Furnizimi me kushineta dhe hilzne"**, me nr. të prokurimit KEKO/16/356/121, ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart dhe dëgjimit të palëve në seancën dëgjimore ia fali besimin ekspertit teknik dhe konform nenit 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Tefik Sylejmani